



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ
Nr. ____/2020

PËR PRESIDENTIN E REPUBLIKËS

Në mbështetje të neneve 6, 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon veprimtarinë e Presidentit të Republikës, organizimin e brendshëm institucional, kompetencat e Presidentit dhe procedurat e ushtrimit të tyre, bashkëveprimin me organet e tjera shtetërore, si dhe aktet që Presidenti nxjerr në ushtrim të kompetencave të veta.

Neni 2
Pozita juridike

1. Presidenti i Republikës është Kryetari i Shtetit. Ai ushtron vetëm kompetencat që i ngarkohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ose me ligj, si Kryetar i Shtetit ose si ndërmjetës dhe ekuilibruer midis pushteteve.
2. Veprimtaria e Presidentit të Republikës udhëhiqet nga parimi i paanësisë, mosndërhyrjes dhe bashkëveprimit me pushtetet.
3. Kompetencat e Presidentit të Republikës ushtrohen brenda kufijve dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Neni 3
Papërgjegjësia dhe imuniteti

1. Presidenti i Republikës nuk mban përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrim të detyrës së tij, përveçse kur ato përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës, sipas këtij ligji.
2. Përgjegjësia për aktet që marrin kundërfirmë është e organit kundërfirmues. Në rastet kur akti që merr kundërfirmë kundërshtohet në rrugë ligjore, atëherë përfaqësimi i Presidentit të Republikës bëhet nga organi kundërfirmues, sikurse detyrimet që i ngarkohen Presidentit për këto akte zbatohen prej tij.
3. Presidenti i Republikës gëzon imunitetin e deputetit. Procedurat e imunitetit për Presidentin e Republikës zbatohen nga Kuvendi, sipas të njejtave rregulla dhe garanci që janë në fuqi për deputetin.

Neni 4 Selia dhe simbolet

1. Selia e Presidentit të Republikës është në Tiranë, në adresën e Presidencës së Republikës.
2. Presidenca është institucioni shtetëror në shërbim të Presidentit të Republikës, i cili përgatit, mbështet dhe asiston Presidentin në veprimtarinë e tij përgjatë mandatit.
3. Presidenti i Republikës ka simbolet e veta, të cilat përdoren krahas simboleve të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 Zgjedhja dhe mandati i Presidentit të Republikës

1. Presidenti i Republikës zgjidhet sipas kushteve, mënyrës dhe procedurave të parashikuara në nenet 86 dhe 87 të Kushtetutës, si edhe në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë.
2. Presidenti i Republikës fillon mandatin pasi të ketë bërë betimin para Kuvendit të Shqipërisë, por jo më parë se të ketë mbaruar mandati i Presidentit që largohet. Betimi kryhet me protokoll ceremonial në seancë solemne, të mbledhur posaçërisht.
3. Mandati i Presidentit të Republikës është 5 vjeçar. Pas përfundimit të mandatit të parë, Presidenti mund të rizgjidhet vetëm për një mandat tjetër.

Neni 6 Zgjatja e mandatit

1. Mandati i Presidentit zgjatet vetëm në kohë lufte dhe për aq kohë sa vazhdon ajo. Zgjatja e mandatit sipas kësaj pike bëhet automatikisht, me kushtin që të jetë në fuqi dekreti për shpalljen e gjendjes së luftës, gjegjësisht vendimi i Kuvendit për miratimin e dekretit ose vendimi i Kuvendit për shpalljen e gjendjes së luftës.
2. Data e shfuqizimit të akteve të shpalljes së gjendjes së luftës shënon datën për fillimin e procedurave për zgjedhjen e presidentit të ri. Mandati i zgjatur përfundon në ditën që Presidenti i zgjedhur bën betimin.

Neni 7 Përfundimi i parakohshëm i mandatit

Mandati i Presidentit të Republikës përfundon në mënyrë të parakoshme kur:

- a) Presidenti jep dorëheqjen;
- b) Presidenti shkarkohet nga detyra;

- c) vërtetohet pamundësia në ushtrimin e detyrës, që krijon vakancë.

Neni 8 Shkarkimi

1. Presidenti i Republikës mund të shkarkohet nga Kuvendi për shkelje të rëndë të Kushtetutës apo për kryejën e një krimi të rëndë.
2. Përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës shkeljet e përcaktuara si të tilla nga ky ligj, si dhe çdo shkelje tjetër që cënon rëndë rendin kushtetues dhe funksionimin e rregullt të pushteteve.
3. Në vlerësimin nëse një shkelje që cënon rëndë rendin kushtetues dhe funksionimin e rregullt të pushteteve është shkelje e rëndë merret në konsideratë:
 - a) rëndësia e normës së shkelur;
 - b) pasojat e ardhura;
 - c) sjellja subjektive e Presidentin në eliminimin apo zbutjen e këtyre pasojave.
4. Presidenti i Republikës shkarkohet sipas procedurës së parashikuar nga neni 90 i Kushtetutës, Rregullorja e Kuvendit dhe ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese.

Neni 9 Pamundësia e ushtrimit të detyrës

1. Presidenti i Republikës ndodhet në pamundësinë e ushtrimit të detyrës në rastet kur për motive shëndetësore, e ka të pamundur perceptimin e mjedisit rrethues ose kur për çfarëdo lloj rrethane tjetër e ka të pamundur komunikimin e lirë e të vullnetshëm. Pamundësia fizike për të ndjekur agjendën e punëve nuk përbën në vetvete shkak për vërtetimin e rastit të pamundësisë.
2. Pamundësia e ushtrimit të detyrës është e përkohëshme ose afatgjatë. Pamundësia është afatgjatë në rastet kur Presidenti nuk mund të ushtrojë detyrën për më shumë se 60 ditë. Pamundësia është e përkohëshme kur zgjat nga 24 orë deri në 60 ditë.
3. Konstatimi i pamundësisë bëhet sipas rastit dhe rrethanave nga Zonja e Parë, drejtori i kabinetit të Presidentit ose sekretari i përgjithshëm i Presidencës, Kryeministri, Ministri i Brendshëm ose i Shëndetësisë, si dhe nga çdo kryetar grupi parlamentar, të cilët vënë në dijeni Kuvendin menjëherë.
4. Për deklarimin e pamundësisë së përkohëshme apo afatgjatë, Kuvendi ngre komision hetimor me detyrën për të shqyrtuar dhe vërtetuar rrethanat e rastit të pamundësisë. Kur pamundësia konstatohet për motive shëndetësore, atëherë komisioni hetimor cakton jo më pak se 5 mjekë, specialistë në fushën përkatëse mjekësore, për t'u shprehur për gjendjen shëndetësore të Presidentit të Republikës. Ekspertiza mjekësore duhet të shprehet, përveç diagnozës dhe protokollit të trajtimit mjekësor edhe për prognozën e sëmundjes dhe ndikimin e saj mbi ushtrimin e detyrës.
5. Komisioni hetimor mund të deklarojë pamundësinë afatgjatë të ushtrimit të detyrës vetëm në rast se rrethanat e rastit krijojnë bindjen, jashtë çdo dyshimi, se Presidentit i Republikës nuk mund t'i kthehet ushtrimit të detyrës brenda 60 ditëve nga konstatimi i pamundësisë. Përndryshe deklarimi i pamundësisë bëhet vetëm me efekt të përkohëshëm.
6. Kur komisioni hetimor konstaton pamundësinë e përkohëshme të ushtrimit të detyrës, çështja i kalon për vendimarrje Kuvendit, i cili vendos me shumicën e votave të të gjithë deputetëve që ushtrimi i përkohëshëm i detyrës së Presidentit të Republikës të bëhet nga Kryetari i Kuvendit. Kryetari i Kuvendit ushtron detyrën e Presidentit të Republikës deri në rikthimin në detyrë të tij.
7. Kur komisioni hetimor konstaton pamundësinë afatgjatë të ushtrimit të detyrës ose kur pamundësia e përkohëshme sipas pikës 6 të këtij neni ka zgjatur 60 ditë, Kuvendi, me dy të

tretat e të gjithë anëtarëve, vendos dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila vërteton përfundimisht faktin e pamundësisë. Në rast të vërtetimit të pamundësisë afatgjatë, vendi i Presidentit mbetet vakant dhe zgjedhja e Presidentit të ri fillon brenda 10 ditëve nga data e vërtetimit të pamundësisë. Kryetari i Kuvendit ushtron detyrën e Presidentit të Republikës deri në fillimin e detyrës nga presidenti i ri.

Neni 10
Papajtueshmëria

1. Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private.
2. Shkelja e këtij parimi, përbën shkelje të rëndë të Kushtetutës.

KREU II
PRESIDENCA

Neni 11
Institucioni

Presidenca e Republikës përbëhet nga kabineti i Presidentit dhe nga administrata e institucionit.

Neni 12
Kabineti i Presidentit të Republikës

1. Kabineti i Presidentit asiston Presidentin e Republikës në trajtimin e të gjitha çështjeve të kompetencës.
2. Kabineti i Presidentit të Republikës përbëhet nga drejtori i kabinetit, këshilltarët, ndihmësit, sekretaria personale e Presidentit dhe sekretaria e kabinetit.
3. Funkionarët e kabinetit emërohen në detyrë, me porosi të Presidentit të Republikës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet nga legjislacioni që rregullon marrëdhënien e punës për funksionarët politikë ose të kabineteve.
4. Struktura dhe organika e kabinetit miratohen si pjesë e organizimit të brendshëm të institucionit.

Neni 13
Administrata

1. Veprimtaria administrative e institucionit kryhet nga personeli administrativ i Presidencës. Nëpunësi më i lartë civil dhe përgjegjës për administrimin e personelit është Sekretari i Përgjithshëm.
2. Struktura organizative e Presidencës përpilohet sipas rregullave që administrojnë strukturën organizative të institucioneve të pavarura, mbështetur në parashikimet buxhetore të miratuara nga Kuvendi. Propozimi për strukturën organizative hartohet nga Sekretari i Përgjithshëm dhe merr pëlqimin nga Presidenti i Republikës, përpara se të kalojë për miratim në Kuvend.
3. Administrata e Presidencës përbëhet nga personel me statusin e nëpunësit civil dhe personel me kontratë pune. Marrëdhëniet respektive të punës rregullohen nga legjislacioni, sipas statusit përkatës.

Neni 14
Detyrat dhe kompetencat e Sekretarit të Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm, nën autoritetin e Presidentit, drejton veprimtarine administrative të institucionit. Ai ka këto detyra:
 - a) mbështet veprimtarinë e Presidentit të Republikës;
 - b) përfaqëson Presidentin dhe institucionin në veprimtari të ndryshme, përcjell mesazhe apo përhëndetje, dorëzon dekorata dhe tituj nderi të akorduara nga Presidenti i Republikës, me porosi të Presidentit të Republikës;
 - c) siguron drejtimin, mbikëqyrjen, koordinimin, si edhe nxjerr urdhra dhe udhëzime për mirëfungsionimin e veprimtarisë administrative të institucionit;
 - ç) bashkëpunon me kabinetin dhe drejton veprimtaritë zyrtare të Presidentit në mjediset e Institucionit;
 - d) drejton dhe bashkërendon punën e strukturave të tjera të institucionit dhe mban përgjegjësi për të gjithë veprimtarinë administrative.
 - dh) siguron bashkëpunimin me organet kushtetuese dhe organet e tjera publike;
 - e) siguron administrim efektiv dhe eficient të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore të administratës së institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - ë) kryen edhe detyra te tjera te ngarkuara, nga legjislacioni në fuqi dhe rast pas rasti, nga Presidenti i Republikës.
2. Sekretari i Përgjithshëm, në rast mungese, paaftësie apo pamundësie, zëvendësohet, për shkak të ligjit, nga nëpunësi civil i nivelit që në hierarki vjen menjëherë poshtë tij. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin civil.
3. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet para Presidentit të Republikës për zbatimin e detyrave.

Neni 15
Buxheti

Buxheti i institucionit përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fushën e buxhetit të shtetit.

KREU III
PROCEDURAT PËR KOMPETENCAT KUSHTITUTIVE

Neni 16
Kufijtë e ushtrimit të kompetencave kushtitutive

1. Kompetencat sipas këtij kreu ushtrohen nga Presidenti i Republikës në cilësinë e organit të lartë shtetëror në procedurat për ngritjen dhe formimin e organeve të tjera
2. Në rrethin e këtyre kompetencave bëjnë pjesë të gjitha kompetencat që përfshijnë Presidentin e Republikës në kontrollin dhe barazpeshën midis pushteteve, si dhe në procedurat për formimin dhe funksionimin e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.
3. Presidenti i Republikës i ushtron kompetencat sipas këtij kreu me paanësi, transparencë dhe llogaridhënie publike.
4. Kompetencat e këtij kreu ushtrohen në emër të organit.

Neni 17

Caktimi i datës së zgjedhjeve

1. Data e zgjedhjeve për Kuvendin, për organet e pushtetit vendor dhe për zhvillimin e referendumeve caktohet nga Presidenti i Republikës me dekret, sipas afateve që përcakton legjislacioni zgjedhor.
2. Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve pas konsultimit me kryetarët ose përfaqësuesit e autorizuar të partive parlamentare. Data e zgjedhjeve përcaktohet nga Presidenti i Republikës mbështetur në konsensusin e partive pjesëmarrëse në konsultë. Në rast se mungon konsensusi, atëherë Presidenti i Republikës cakton datën e zgjedhjeve, sipas propozimit të partisë apo partive që mbajnë numrin më të madh të mandateve parlamentare.
3. Presidenti i Republikës mund të shtyjë datën e zgjedhjeve apo mbajtjes së referendumit në këto rrethana:
 - a) kur kompetenca i njihet shprehimisht në ligjin për zgjedhjet ose ligjin për referendumet;
 - b) vetëm në zbatim të masave të jashtëzakonshme;
 - c) vetëm për interesa madhore në dobi të zgjedhjeve, me kusht që data e re e zgjedhjeve të mos zgjasë mandatin e organeve që përtërihen.
4. Shtyrja e datës së zgjedhjeve mund të bëhet vetëm duke zbatuar procedurat sipas pikës 2 të këtij neni.
5. Në rast se Presidenti i Republikës nuk nxjerr dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve në afatin e përcaktuar nga legjislacioni zgjedhor ose e nxjerr atë në kundërshtim me procedurën sipas këtij neni, atëherë data e zgjedhjeve caktohet nga Kuvendi, sipas propozimit të Kryetarit të tij, me vendim që miratohet me shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, brenda 10 ditëve nga afati i dekretimit.

Neni 18

Thirrja e Kuvendit në legjislaturën e re

1. Thirrja e Kuvendit në legjislaturën e re bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret. Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e porsazgjedhur jo më parë se data e përfundimit të mandatit të Kuvendit paraardhës, por jo më vonë se 10 ditë pas mbarimit të këtij mandati.
2. Kur Kuvendi paraardhës është shpërndarë para mbarimit të mandatit, Presidenti i Republikës e mbledh Kuvendin e ri jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve.
3. Presidenti i Republikës bën thirrjen e Kuvendit në legjislaturën e re, pas konsultimit me kryetarët ose përfaqësuesit e autorizuar të partive që kanë fituar mandate nga zgjedhjet.
4. Data për thirrjen e Kuvendit përcaktohet nga Presidenti i Republikës mbështetur në konsensusin e partive pjesëmarrëse në konsultë. Në rast se mungon konsensusi, atëherë Presidenti i Republikës cakton datën e thirrjes së Kuvendit në legjislaturën e re, sipas propozimit të partisë apo partive që mbajnë numrin më të madh të mandateve parlamentare.
5. Në rast se Presidenti i Republikës nuk thërret Kuvendin në legjislaturën e re, deri ditën e fundit të afatit të parashikuar në pikën 1 ose 2 të këtij neni, Kuvendi vetëmbledhet në këtë ditë.

Neni 19

Shpërndarja e Kuvendit

1. Shpërndarja e Kuvendit bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret në rastet kur Kuvendi nuk arrin të miratojë në dy raunde Kryeministrat e emëruar dhe as të zgjedhë vetë Kryeministër tjetër, si dhe në rastin kur Kryeministri humbet mocionin e besimit dhe i kërkon Presidentit të Republikës që të shpërndajë Kuvendin.
2. Presidenti i Republikës shpërndan Kuvendin, sipas rastit, brenda 10 ditëve nga data e votimit pa sukses në Kuvend për zgjedhjen e Kryeministrit, apo nga kalimi i afatit 10 ditor për zgjedhjen e

Kryeministrit nga Kuvendi, ose brenda 10 ditëve nga data që merr kërkesën e Kryeministrit për shpërndarjen e Kuvendit.

3. Në rast se Presidenti i Republikës nuk nxjerr dekretin për shpërndarjen e Kuvendit brenda afatit sipas pikës 2 të këtij neni, Kuvendi quhet i shpërndarë ipso lege. Me kalimin e këtij afati Kuvendi dhe komisionet parlamentare të tij nuk mund të ushtrojnë më funksionet e tyre. Çdo akt i miratuar në kushtet e shpërndarjes ipso lege është absolutisht i pavlefshëm, përveçse kur Republika e Shqipërisë vendoset në kushtet e parashikuara nga neni 66 i Kushtetutës për rithirrjen vetiu të Kuvendit të shpërndarë.
4. Presidenti i Republikës është i detyruar të nxjerrë dekretin për caktimin e datës së zgjedhjeve jo më vonë se 24 orë pas shpërndarjes me dekret ose ipso lege të Kuvendit.

Neni 20

Emërimi i Kryeministrit

1. Emërimi i Kryeministrit bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret. Emërimi i Kryeministrit është nismëtar kur procedura për emërimin e kryeministrit nis nga Presidenti i Republikës dhe është pasues kur procedura nis nga Kuvendi. Kryeministri i emëruar duhet të gëzojë mbështetjen e partisë ose koalicionit të partive që kanë shumicën e vendeve në Kuvend.
2. Emërimi nismëtar bëhet në fillim të legjislaturës ose kur posti i Kryeministrit ngelet vakant dhe përfshin emërimin sipas pikave 5, 6 dhe 7 të këtij neni.
3. Emërimi pasues i Kryeministrit bëhet në rastet kur Kryeministri zgjidhet nga Kuvendi pas përfundimit pa sukses të procedurave për miratimin e Kryeministrit të emëruar, kur zgjidhet për shkak të mosushtimit nga Presidenti i Republikës të kompetencës për emërim ose të moszbatimit të procedurës së emërimit, si dhe kur zgjidhet me mocion mosbesimi. Emërimi pasues i Kryeministrit bëhet nga Presidenti i Republikës pa zhvilluar procedura konsultimi.
4. Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për emërimin e Kryeministrit, në rastin e emërimit nismëtar, brenda 10 ditëve nga mbledhja e parë e legjislaturës së re të Kuvendit, brenda 10 ditëve nga përfundimi pa sukses i raundit të parë për miratimin nga Kuvendi të Kryeministrit të emëruar, ose brenda 10 ditëve nga krijimi i vakancës. Për emërimin pasues, Presidenti i Republikës nxjerr dekretin për emërimin e Kryeministrit brenda 10 ditëve nga votimi në Kuvend për Kryeministrin e zgjedhur nga vetë Kuvendi.
5. Presidenti i Republikës bën emërimin nismëtar të Kryeministrit, pas konsultimit me kryetarët ose përfaqësuesit e autorizuar të partive që kanë mandate në Kuvend. Konsulta ka qëllim të identifikojë kandidatin që gëzon mbështetjen e shumicës së Kuvendit dhe që mund të marrë miratimin në Kuvend. Kryetarët ose përfaqësuesit e autorizuar të partive që kanë mandate në Kuvend mund t'i paraprijnë konsultës me Presidentin e Republikës me takime eksploruese midis tyre, me qëllim që të lehtësojnë përafrimin drejt kandidaturave të përbashkëta.
6. Në rast se përfaqësuesit e partive politike nuk i japin mbështetjen e mjaftueshme asnjë kandidati të mundshëm, atëherë Presidenti i Republikës emëron Kryeministër dhe dërgon për miratim kandidatin e partisë që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend.
7. Në rast se kandidati i emëruar nuk miratohet në raundin e parë të votimit, atëherë Presidenti i Republikës rinis konsultën me kryetarët ose përfaqësuesit e autorizuar të partive që kanë mandate në Kuvend. Në rast se përfaqësuesit e partive politike nuk i japin mbështetjen e mjaftueshme asnjë kandidati të mundshëm, atëherë Presidenti i Republikës emëron Kryeministër dhe dërgon për miratim kandidatin e partisë së dytë me numrin më të madh të vendeve në Kuvend.
8. Në rast se kandidati i emëruar në raundin e dytë nuk miratohet, atëherë Presidenti i Republikës emëron Kryeministrin e zgjedhur nga Kuvendi, ose shpërndan Kuvendin, kur Kuvendi nuk arrin të zgjedhë vetë Kryeministrin e ri.

9. Në rast se Presidenti i Republikës nuk nxjerr dekretin për emërimin nismëtar të Kryeministrit, ose nuk e nxjerr atë sipas procedurës së përcaktuar në pikat 5, 6 dhe 7 të këtij neni, atëherë Kryeministri zgjidhet drejtpërdrejt nga Kuvendi. Në këtë rast zbatohen gjegjësisht procedurat që rregullojnë parashikohen për zgjedhjen e Kryeministrit me mocion mosbesimi.
10. Në rast se Presidenti i Republikës nuk nxjerr dekretin për emërimin pasues të Kryeministrit, brenda 10 ditëve nga zgjedhja, atëherë Kryeministri i zgjedhur i paraqet Kuvendit për miratim përbërjen dhe programin e qeverisë, pavarësisht nga mungesa e dekretit për emërim. Kryeministri, zëvendeskryeministri dhe ministrat e miratuar sipas kësaj pike bëjnë betimin drejtpërdrejt në Kuvend, pavarësisht nga mungesa e dekretit për emërim.

Neni 21

Emërimi i ministrave

1. Ministrat emërohen nga Presidenti i Republikës me dekret, sipas propozimit të Kryeministrit. Dekreti kundërfirmohet nga Kryeministri.
2. Në rast se Presidenti i Republikës konstaton përpara emërimit, se ministri i propozuar nuk plotëson ndonjë nga kushtet për të qenë deputet, nuk ka shtetësinë apo moshën e kërkuar, ose nuk ka dhënë dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit, prokurorit, ushtarakut të shërbimit aktiv, punonjësit të policisë apo të sigurimit kombëtar, përfaqësuesit diplomatik, apo të kryetarit të bashkisë apo prefektit, përpara momentit të propozimit, atëherë Presidenti i Republikës informon me shkrim Kryeministrin për pengesën për emërim, duke i kërkuar tërheqjen e propozimit dhe zëvendësimin me një kandidaturë tjetër, brenda 7 ditëve nga marrja e propozimit.
3. Presidenti i Republikës nuk mund të vonojë apo pengojë emërimin e ministrit të propozuar për asnjë motiv apo shkak tjetër, përveç atyre të pikës 2 të këtij neni.
4. Në rast se Presidenti i Republikës nuk nxjerr dekretin për emërimin e ministrit të propozuar nga Kryeministri brenda 7 ditëve nga marrja e propozimit, atëherë Kryeministri ia paraqet propozimin Kuvendit për miratim, pavarësisht nga mungesa e dekretit për emërim. Ministri i miratuar sipas kësaj pike bën betimin drejtpërdrejt në Kuvend, pavarësisht nga mungesa e dekretit për emërim.

Neni 22

Emërimet në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën e Lartë

1. Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që janë emërtësë e Presidentit të Republikës emërohen në detyrë me dekret, brenda afateve të përcaktuara nga ligji përkatës. Dekreti kundërfirmohet, sipas rastit, nga Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ose nga Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Presidenti i Republikës emëron anëtarin e Gjykatës kushtetuese midis 3 kandidaturave që i paraqiten nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pa të drejtë refuzimi ose modifikimi të listës. Dekreti i emërimit shpallet i shoqëruar me arsyet e përzgjedhjes së kandidatit. Nëse Presidenti nuk bën emërimin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.
3. Në rast se Presidenti i Republikës konstaton përpara emërimit, se kandidati i propozuar për gjyqtar në gjykatën e Lartë nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sikurse përcaktohen shprehimisht në ligj, atëherë Presidenti i Republikës informon me shkrim organin propozues për pengesën për emërim, duke i kërkuar rishikimin e propozimit, brenda 10 ditëve.
4. Presidenti i Republikës nuk mund të vonojë apo pengojë emërimin për asnjë motiv apo shkak tjetër, përveç atyre të pikës 3 të këtij neni.

5. Në rast se organi propozues informon me shkrim Presidentin e Republikës se i qendron propozimit edhe pas njoftimit me shkrim sipas pikës 3 të këtij neni, atëherë Presidenti i Republikës mund të refuzojë emërimin, duke nxjerrë dekret për mosemërimin në detyrë të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit nga organi propozues. Dekreti për mosemërimin në detyrë nuk kundërfirmohet.
6. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit për gjyqtar të Gjykatës së Lartë humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 23

Propozimi i kandidaturave Kuvendit

1. Në rastet kur ligji parashikon kompetencën e Presidentit të Republikës për t'i propozuar Kuvendit emërimin ose zgjedhjen e zyrtarëve të lartë, propozimi nga Presidenti i Republikës bëhet me shkresë drejtuar Kuvendit.
2. Presidenti i Republikës përzgjedh kandidaturat që plotësojnë kushtet dhe kriteret me thirrje publike ose duke kërkuar kandidaturat midis personaliteteve publike të fushës.
3. Përpara paraqitjes së propozimit, Presidenti i Republikës konsulton me kryetarët ose përfaqësuesit e autorizuar të partive parlamentare të gjitha kandidaturat e ofruara, të propozuara, apo të përzgjedhura. Konsulta ka qëllim të identifikojë kandidatin që gëzon mbështetjen e shumicës së Kuvendit dhe që mund të marrë miratimin në Kuvend.
4. Kandidati që rezulton se ka mbështetjen e mjaftueshme dhe mund të marrë miratimin në Kuvend i propozohet Kuvendit nga Presidenti i Republikës. Në rast se nga konsulta rezulton se asnjë kandidaturë nuk siguron mbështetjen e nevojshme, atëherë Presidenti i Republikës rinis procedurën përzgjedhëse për të identifikuar kandidatura të tjera.
5. Në rastin kur Presidenti i Republikës nuk paraqet propozim brenda afateve të përcaktuara ligjore ose kur nuk e paraqet propozimin sipas kësaj procedure, atëherë Kuvendi zgjedh ose emëron vetë zyrtarin e lartë. Në këtë rast Kuvendi zbaton procedurat sipas rregullores për zgjedhjen e organeve kushtetuese ose të ngritura me ligj.

Neni 24

Procedurat e betimit

1. Betimi përpara Presidentit të Republikës është akti solemn që i paraprin fillimit të detyrës nga ana e funksionarëve apo gjyqtarëve të lartë. Betimi përpara Presidentit të Republikës bëhet vetëm për funksionarët dhe gjyqtarët, për të cilët ligji i posaçëm parashikon kryerjen e betimit.
2. Organizimi i ceremonisë së betimit nga ana e Presidentit të Republikës është detyrim shtetëror që buron nga qenia Kryetar i Shtetit. Ceremonia e betimit bëhet në emër të Republikës së Shqipërisë dhe nuk ka lidhje me kompetencat kushtitutive të presidentit në raport me të njëjtët funksionarë ose gjyqtarë. Presidenti i Republikës është i detyruar të organizojë ceremoninë e betimit, pavarësisht nëse jep apo jo pëlqimin për ta.
3. Procedura e betimit bëhet në praninë e zyrtarëve të lartë të Presidencës, të përfaqësuesve të organit që ka zgjedhur, miratuar apo propozuar funksionarin a gjyqtarin që betohet, të përfaqësuesve nga organi ku ai do ushtrojë funksionet, si dhe të një numri të ftuarish nga rrethi i afërt i tij.
4. Presidenti i Republikës organizon ceremoninë e betimit jo më vonë se 10 ditë nga data kur atij i ka lindur detyrimi për të organizuar dhe kryer këtë ceremoni.

5. Në rast se ceremonia e betimit nuk organizohet nga Presidenti i Republikës deri në përfundim të afatit sipas pikës 4 të këtij neni, atëherë betimi kryhet përpara Kuvendit, për të gjithë funksionarët apo gjyqtarët që zgjidhen apo miratohen prej tij, kurse për të tjerët përpara organit propozues.

Neni 25 Procedurat e shkarkimit

1. Shkarkimi nga detyra i Kryeministrit apo i ministrit bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret, përpara dhe për shkak të emërimit të kryeministrit apo të ministrit të ri. Dekreti për shkarkimin e ministrit kundërfirmohet nga Kryeministri.
2. Presidenti i Republikës nuk mund të vonojë apo pengojë shkarkimin e Kryeministrit apo ministrit për asnjë motiv apo shkak.
3. Në rast se Presidenti i Republikës nuk nxjerr dekretin për shkarkimin e Kryeministrit apo të ministrit brenda afatit kushtetues, atëherë Kuvendi miraton shkarkimin, pavarësisht nga mungesa e dekretit për shkarkim.

Neni 26 Refuzimi për të zbatuar procedurat kushtitutive

Refuzimi nga ana e Presidentit të Republikës për të zbatuar procedurat kushtitutive, ose zbatimi i tyre në kundërshtim me parashikimet e këtij kreu përbën shkelje të rëndë të kushtetutës, shkak të mjaftueshëm për të nisur procedurën e shkarkimit sipas nenit 90 të Kushtetutës.

KREU IV PROCEDURAT PËR KOMPETENCAT SI KRYETAR I SHTETIT

Neni 27 Kufijtë e ushtrimit të kompetencave si Kryetar i Shtetit

1. Kompetencat sipas këtij kreu ushtrohen nga Presidenti i Republikës në cilësinë e Kryetarit të Shtetit.
2. Në rrethin e këtyre kompetencave përfshihen falja e dënimit, dhënia dhe lejimi i lënies së shtetësisë, emërimi dhe shkarkimi i zyrtarëve dhe oficerëve me gradë madhore, emërimi i akademikëve, dhënia e dekoratave dhe e titujve të nderit dhe dhënia e gradave të larta ushtarake.
3. Kompetenca për marrjen, përpunimin, shqyrtimin dhe verifikimin e kërkesave të individëve për çështje të kësaj natyre i takon organeve të administratës publike të caktuara me ligj. Presidenti i Republikës administron vetëm propozimet e organeve kompetente, verifikon ligjëshmërinë e tyre dhe, nëpërmjet dekretimit, u jep atyre forcën, autoritetin dhe solemnitetin e figurës së Kryetarit të Shtetit.
4. Kompetencat e këtij kreu ushtrohen në emër të Republikës së Shqipërisë.

Neni 28 Falja

1. Falja jepet nga Presidenti i Republikës me dekret, me propozim të Ministrit të Drejtësisë, brenda 30 ditëve nga marrja e propozimit. Dekreti kundërfirmohet nga ministri propozues.

2. Presidenti i Republikës vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës për falje mbështetur vetëm në shkaqe të përcaktuara shprehimisht nga ligji dhe vetëm në referim të rrethanave të dokumentuara e të provuara të rastit.
3. Në rast se gjykimi i Presidentit të Republikës është i kundërt me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, atëherë Presidenti i Republikës informon me shkrim, në mënyrë të detajuar dhe me arsyetim ligjor, Ministrin e Drejtësisë, duke i kërkuar të rishikojë propozimin, brenda 10 ditëve.
4. Kërkesat për falje dënimi, për të cilat Presidenti i Republikës dhe Ministri i Drejtësisë kanë gjykim të kundërt dhe që nuk dekretohen brenda afatit quhen të rrëzuara.

Neni 29 Shtetësia

1. Dhënia e shtetësisë shqiptare dhe lejimi i lënies së saj bëhen nga Presidenti i Republikës me dekret, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e brendshme, brenda 60 ditëve nga marrja e propozimit. Dekreti kundërfirmohet nga ministri propozues.
2. Presidenti i Republikës vendos për pranimin ose refuzimin e kërkesës për dhënien e shtetësisë ose lejimin e lënies së saj mbështetur vetëm në shkaqe të përcaktuara shprehimisht nga ligji dhe vetëm në referim të rrethanave të dokumentuara e të provuara të rastit.
3. Në rast se gjykimi i Presidentit të Republikës është i kundërt me propozimin e ministrit që mbulon çështjet e brendshme, atëherë Presidenti i Republikës informon ministrin me shkrim, në mënyrë të detajuar dhe me arsyetim ligjor, duke i kërkuar të rishikojë propozimin, brenda 10 ditëve.
4. Kërkesat, për të cilat Presidenti i Republikës dhe ministri që mbulon çështjet e brendshme kanë gjykim të kundërt quhen të rrëzuara.

Neni 30 Emërimi dhe shkarkimi i zyrtarëve dhe oficerëve me gradë madhore

1. Zyrtarët dhe oficerët me gradë madhore që janë emërtesë e Presidentit të Republikës emërohen në detyrë me dekret, brenda afateve të përcaktuara nga ligji përkatës ose, në mungesë të tyre, brenda 10 ditëve nga marrja e propozimit. Dekreti kundërfirmohet, sipas rastit, nga Kryeministri ose ministri përgjegjës.
2. Në rast se Presidenti i Republikës konstaton përpara emërimit, se propozimi është në kundërshtim me kushtet për emërim, sikurse përcaktohen shprehimisht në ligj, atëherë Presidenti i Republikës informon me shkrim organin propozues për pengesën për emërim, duke i kërkuar rishikimin e propozimit, brenda 10 ditëve.
3. Presidenti i Republikës nuk mund të vonojë apo pengojë emërimin për asnjë motiv apo shkak tjetër, përveç atyre të pikës 2 të këtij neni.
4. Në rast se organi propozues informon me shkrim Presidentin e Republikës se i qendron propozimit edhe pas njoftimit me shkrim sipas pikës 2 të këtij neni, atëherë Presidenti i Republikës mund të refuzojë emërmin, duke nxjerrë dekret për mosemërimin në detyrë të zyrtarit ose oficerit me gradë madhore, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit nga organi propozues. Dekreti për mosemërimin në detyrë nuk kundërfirmohet.
5. Organi propozues dhe kandidati i propozuar kanë të drejtë të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative kompetente kundër dekretit për mosemërimin në detyrë.
6. Shkarkimi nga detyra i zyrtarëve të lartë dhe oficerëve me gradë madhore bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret, brenda 10 ditëve nga marrja e propozimit. Dekreti kundërfirmohet, sipas rastit, nga Kryeministri ose ministri përgjegjës.

7. Në rast se Presidenti i Republikës konstaton përpara shkarkimit, se propozimi është në kundërshtim me kushtet për shkarkim, sikurse përcaktohen shprehimisht në ligj, atëherë Presidenti i Republikës informon me shkrim organin propozues, duke i kërkuar rishikimin e propozimit, brenda 10 ditëve.
8. Presidenti i Republikës nuk mund të vonojë apo pengojë shkarkimi për asnjë motiv apo shkak tjetër, përveç atij të pikës 7 të këtij neni.
9. Në rast se organi propozues informon me shkrim Presidentin e Republikës se i qendron propozimit edhe pas njoftimit me shkrim sipas pikës 7 të këtij neni, atëherë Presidenti i Republikës mund të refuzojë shkarkimin, duke nxjerrë dekret për mosshkarkim të zyrtarit, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit nga organi propozues. Dekreti për mosshkarkimin nga detyra nuk kundërfirmohet.
10. Organi propozues ka të drejtë të bëjë ankim në Gjykatën Administrative kompetente kundër dekretit për mosshkarkim.

Neni 31

Dekoratat dhe titujt e nderit

1. Dekoratat dhe titujt e nderit jepen nga Presidenti i Republikës me dekret, me propozim të organeve të përcaktuara me ligj. Dekreti kundërfirmohet nga organi propozues.
2. Organet propozuese e paraqesin propozimin me motivacion të përcaktuar, me shpjegim të hollësishëm për meritën dhe me referenca të plota dokumentare për verifikim. Presidenti i Republikës, mund të përfshijë në shqyrtim dhe të kërkojë mendimin e institucioneve të specializuara, apo të studiuesve të fushës, për verifikimin e fakteve historike që motivojnë propozimin.
3. Në rast se nga shqyrtimi i trupave këshillimore të ngarkuara më çështjen rezultojnë të dhëna faktike të ndryshme apo të kundërta me ato të përfshira në propozim, të cilat nuk mbështesin propozimin e paraqitur, apo mbështesin dhënien e një dekorate apo titulli të ndryshëm nga ai i propozuar, atëherë Presidenti i Republikës vë në dijeni me shkrim organin propozues rreth tyre, duke i kërkuar të rishikojë propozimin, brenda 10 ditëve.
4. Propozimet për dhënien e dekoratave apo titujve, për të cilat Presidenti i Republikës dhe organi propozues kanë gjykim të kundërt quhen të rrëzuara.
5. Procedurat e tjera për shqyrtimin dhe miratimin e dekoratave dhe titujve të nderit nga Presidenti i Republikës përcaktohen në ligjin që rregullon dhënien e dekoratave, titujve të nderit, medaljeve dhe titujve vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Gradat e larta ushtarake

1. Gradat madhore u jepen oficerëve nga Presidenti i Republikës me dekret, me propozimin, sipas rastit, të Kryeministrit ose të Ministrit të Mbrojtjes. Dekreti kundërfirmohet nga organi propozues.
2. Organet propozuese e paraqesin propozimin me motivacion të përcaktuar, me shpjegim të hollësishëm për ligjëshmërinë dhe meritën dhe me referenca të plota dokumentare për verifikim.
3. Në rast se nga shqyrtimi Presidenti i Republikës konstaton se propozimi vjen në kundërshtim me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara shprehimisht në ligj, atëherë Presidenti i Republikës informon me shkrim organin propozues, duke i kërkuar të rishikojë propozimin, brenda 10 ditëve.
4. Propozimet për dhënien gradave madhore, për të cilat Presidenti i Republikës dhe organi propozues kanë gjykim të kundërt quhen të rrëzuara.

Neni 33

Emërimi i akademikëve

1. Presidenti i Republikës emëron me dekret drejtuesin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e institucioneve të arsimit të lartë, në rastin kur ligjet përkatëse e ngarkojnë me këtë detyrë, sipas procedurave të përcaktuara në këto ligje, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.
2. Përpara emërimit, Presidenti i Republikës verifikon vetëm ligjëshmërinë e procedurës paraprirëse dhe nëse ka kontestime ende të pazgjdhura rreth saj, të cilat pengojnë dekretimin. Në këtë rast Presidenti i Republikës vë në dijeni kërkuesit për paligjshmëritë ose kontestimet, duke referuar tek shkaqet dhe referencat konkrete ligjore dhe u kërkon atyre korrigjimin e kërkesës, brenda 10 ditëve.
3. Në rast se kërkesa i riparaqitet pa ndryshime, atëherë Presidenti i Republikës mund të refuzojë emërimin, duke nxjerrë dekret për mosemërimin, brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës.
4. Kërkuesi dhe kandidati kanë të drejtë të bëjnë ankim në Gjykatën Administrative kompetente kundër dekretit për mosshkarkim.

Neni 34

Refuzimi për të zbatuar procedurat lidhur me kompetencat si Kryetar i Shtetit

Refuzimi nga ana e Presidentit të Republikës për të zbatuar procedurat lidhur me kompetencat si Kryetar i Shtetit, zbatimi i tyre në kundërshtim me parashikimet e këtij kreu, si dhe rrëzimi i propozimeve kundërshtohet nga organet e tjera shtetërore apo personat e interesuar në rrugë ligjore në gjykatën kompetente administrative.

KREU V

PROCEDURAT E PROCESIT LIGJVËNËS

Neni 35

Procedura për shpalljen e ligjeve

1. Shpallja e ligjit bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret, brenda 20 ditëve nga marrja e tij nga Kuvendi. Dekreti për shpalljen e ligjit i dërgohet nga Presidenca Qendër së Botimeve Zyrtare, së bashku me kopjen zyrtare të ligjit të shpallur. Ligji botohet në Fletoren Zyrtare me shënimin referues për numrin dhe datën e dekretit të shpalljes.
2. Shqyrtimi i ligjit përpara shpalljes nga Presidenti i Republikës bëhet mbështetur në parimin e paanësisë, transparencës dhe llogaridhënies publike.
3. Presidenti i Republikës shqyrton vetëm kushtetueshmërinë dhe pajtueshmërinë e ligjit me ligjet me forcë më të lartë juridike.
4. Në rast se Presidenti i Republikës konstaton papajtueshmëri të ligjit të miratuar me Kushtetutën ose me ligjet me forcë më të lartë juridike, atëherë ai ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë. Presidenti i Republikës nuk mund t'a kthejë ligjin për rishqyrtim për shkak se nuk pajtohet me qëllimet, objektivat, mekanizmat, procedurat apo efektet e pritshme të ligjit.
5. Kthimi për rishqyrtim nga Presidenti i Republikës bëhet me dekret. Dekreti shoqërohet me relacion të arsyetuar të hollësishëm për shkaqet e kthimit për rishqyrtim, analizën ligjore të papajtueshmërive dhe referencat konkrete.
6. Dekreti për kthimin për rishqyrtim të ligjit rrëzohet kur më shumë se gjysma e deputetëve të Kuvendit votojnë kundër tij. Kur dekreti për kthimin për rishqyrtim të ligjit rrëzohet, ligji nuk i ridërgohet Presidentit të Republikës për shpallje. Vendimi i Kuvendit për rrëzimin e dekretit është njëkohësisht akti i shpalljes së ligjit. Vendimi i dërgohet nga Kuvendi Qendër së Botimeve Zyrtare, së bashku me kopjen zyrtare të ligjit. Në këtë rast ligji mban numërtimin dhe datën e miratimit të parë. Ligji botohet

në Fletoren Zyrtare me shënimin referues për numrin dhe datën e dekretit për kthimin për rishqyrtim dhe datën e vendimit të Kuvendit për rrëzimin e dekretit.

7. Dekreti për kthimin për rishqyrtim miratohet kur kundër tij votojnë më pak se gjysma e deputetëve të Kuvendit. Në këtë rast, ligji rifutet në procedurën e shqyrtimit parlamentar. Ligji i miratuar në përfundim të kësaj procedure merr numërtim dhe datë të re miratimi dhe i dërgohet Presidentit të Republikës për shpallje. Për ligjin e ri, Presidenti i Republikës ruan të drejtën e kthimit për rishqyrtim sipas këtij neni.
8. Në rastet kur Presidenti i Republikës nuk shpall ligjin ose nuk e kthen atë për rishqyrtim brenda 20 ditëve nga marrja e tij, Kuvendi ia dërgon ligjin Qendrës së Botimeve Zyrtare për botim në Fletoren Zyrtare, me shkresë të nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Botimi në Fletoren Zyrtare bëhet me shënimin: “Botuar pas kalimit të afatit për shpallje”.

Neni 36

Nxjerrja e akteve me fuqinë e ligjit

1. Nxjerrja e akteve me fuqinë e ligjit bëhet nga Presidenti i Republikës me dekret, me propozim të Këshillit të Ministrave, brenda 3 ditëve nga paraqitja e tyre. Dekreti kundërfirmohet nga Kryeministri.
2. Nxjerrja e akteve me fuqinë e ligjit bëhet vetëm kur Kuvendi nuk mund të mbledhet gjatë gjendjes së luftës. Dekreti duhet të miratohet nga Kuvendi në mbledhjen e tij më të parë.
3. Përpara nxjerrjes së aktit me fuqinë e ligjit, Presidenti i Republikës shyrton kushtetueshmërinë dhe pajtueshmërinë e aktit me ligjet me forcë më të lartë juridike.
4. Në rast se Presidenti i Republikës konstaton papajtueshmëri të aktit me Kushtetutën ose me ligjet me forcë më të lartë juridike, atëherë ai informon Këshillin e Ministrave për papajtueshmërinë duke e shoqëruar analizën ligjore për papajtueshmërinë dhe referencat konkrete.
5. Në rast se Këshilli i Ministrave e riparaqet aktin pa ndryshime, atëherë Presidenti i Republikës e dekreton atë, brenda 3 ditëve.

Neni 37

Marrëveshjet ndërkombëtare

1. Presidenti i Republikës nënshkruan apo autorizon Kryeministrin, anëtarët e Këshillit të Ministrave apo çdo zyrtar të lartë të nënshkruajnë marrëveshjet ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë, sipas kërkesës, procedurave dhe dokumentacionit të paraqitur nga Ministria e Punëve të Jashtme.
2. Presidenti i Republikës nënshkruan autorizimin për Ministrin e Punëve të Jashtme për lëshimin e plotfuqisë për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, sipas kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga ministria e punëve të jashtme.
3. Presidenti i Republikës nënshkruan autorizimin për Ministrin e Punëve të Jashtme për lëshimin e kredencialeve për pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, sipas kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur nga ministria e punëve të jashtme.

Neni 38

Shpallja e gjendjes së luftës

1. Gjendja e luftës shpallet nga Presidenti i Republikës me dekret, me kërkesë të Këshillit të Ministrave, në rast agresioni të armatosur kundër Republikës së Shqipërisë, brenda 3 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Dekreti përmban edhe dispozitat që urdhërojnë kufizimin e të drejtave, ku specifikohen të drejtat që kufizohen, lloji dhe masa e kufizimit. Dekreti kundërfirmohet nga Kryeministri.

2. Presidenti i Republikës mund ta kthejë kërkesën e Këshillit të Ministrave për rishqyrtim, vetëm nëse konstaton, me arsyetim të hollësishëm dhe të mbështetur në fakte, se mungon shkaku ligjor për shpalljen e gjendjes së luftës.
3. Në rast se Këshilli i Ministrave e riparaqet kërkesën pa ndryshime, atëherë Presidenti i Republikës e dekreton atë, brenda 3 ditëve.
4. Dekreti i Presidentit të Republikës i paraqitet Kuvendit për miratim brenda 48 orëve nga nënshkrimi. Kuvendi merr në shqyrtim menjëherë dhe vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve për dekretin e Presidentit.
5. Në rast kërcënimesh të jashtme ose kur detyrimi për mbrojtje të përbashkët buron nga një marrëveshje ndërkombëtare, shpallja e gjendjes së luftës, si dhe vendosja e gjendjes së mobilizimit dhe të çmobilizimit të përgjithshëm ose të pjesshëm bëhen nga Kuvendi, me propozim të Presidentit të Republikës. Presidenti i Republikës e bën propozimin me shkresë drejtuar Kuvendit, të shoqëruar me arsyetimin e hollësishëm dhe të mbështetur në fakte dhe referenca ligjore konkrete.

KREU VI

AKTET E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

Neni 39

Aktet që nxjerr Presidenti

Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj, nxjerr:

- a) dekrete;
- b) mesazhe drejtuar Kuvendit;
- c) kërkesë për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese;
- c) shkresa;
- ç) autorizime.

Neni 40

Dekreti

1. Dekreti është akti kryesor që Presidenti i Republikës nxjerr në ushtrim të kompetencave të tij si Kryetar i Shtetit dhe si organ i lartë shtetëror.
2. Dekretet për caktimin e datës së zgjedhjeve, për thirjen e Kuvendit në legjislaturën e re, për shpërndarjen e Kuvendit, për emërimin dhe shkarkimin e Kryeministrit, për emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për emërimin e kryetarit të akademisë së shkencave dhe rektorëve, si dhe dekreti për shpalljen e ligjit bëhen pa kundërfirmim. Të gjitha dekretet e tjera bëhen me kundërfirmimin e organit propozues.
3. Dekreti që kërkon kundërfirmim nënshkruhet nga Presidenti i Republikës dhe i dërgohet për kundërfirmë sipas rastit Kryeministrit, Ministrit apo titullarit të institucionit sipas këtij ligji, në tre kopje. Kundërfirmuesi e nënshkruan dekretin brenda 10 ditësh nga data e paraqitjes së tij dhe një kopje të tij e arkivon në institucion, ndërsa dy kopjet të tjera ia dërgon Presidentit të Republikës. Kundërfirmuesi nuk lejohet të publikojë, shpërndajë, dorëzojë apo komunikojë dekretin tek të tretët, në çfarëdo mënyre.
4. Kundërfirmuesi nuk mund të refuzojë nënshkrimin, nëse dekreti është në përputhje me propozimin e tij.

5. Dekreti i kundërfirmuar fiton cilësinë e plotë të aktit. Pas momentit të kundërfirmimit as kundërfirmuesi, as Presidenti i Republikës nuk mund të tërheqin nënshkrimin nga akti. Akti merr fuqi juridike dhe mund të rrëzohet vetëm në rrugën ligjore për rrëzimin e akteve administrative.
6. Dekretet që kërkojnë botimin në Fletoren Zyrtare dërgohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës për botim.
7. Presidenca e Republikën krijon dhe mban Rregjistrin e Dekreteve. Ky rregjistër mbahet në formë shkresore dhe në formë elektronike dhe bëhet publik edhe në faqen e internetit të Presidentit të Republikës.

Neni 41 Mesazhet drejtuar Kuvendit

1. Presidenti i Republikës në zbatim të nenit 92, shkronja "a" të Kushtetutës ka të drejtë t'i drejtojë mesazhe Kuvendit.
2. Mesazhet e Presidentit drejtuar Kuvendit përmbajnë qëndrimet e Presidentit të Republikës për çështje me rëndësi në jetën politike të vendit dhe/ose çështjet ndërkombëtare, mendime vlerësime dhe propozime për politikën e ndjekura nga pushteti ekzekutiv dhe/ose Kuvendi, të cilat i shërbejnë interesit të përgjithshëm. Nëpërmjet mesazheve Presidenti i Republikës tërheq vëmendjen e politikës dhe sensibilizon opinionin publik.
3. Përmbajtja e Mesazhit të Presidentit duhet të respektojë rolin kushtetues të Presidentit të Republikës si përfaqësues i unitetit të popullit dhe paanësinë politike të tij.
4. Presidenti e paraqet personalisht mesazhin në Kuvend në seancë solemne plenare. Kuvendi nuk zhvillon asnjë debat dhe diskutim në lidhje me mesazhin e drejtuar nga Presidenti i Republikës.

Neni 42 Kërkesa drejtuar Gjykatës Kushtetuese

1. Presidenti ka të drejtë të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me anë të kërkesës.
2. Kërkesa hartohet në përputhje me ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe nënshkruhet personalisht prej Presidentit të Republikës.

Neni 43 Shkresa

1. Shkresa është dokument zyrtar me anë të së cilës realizohet veprimtaria zyrtare e Presidentit të Republikës për çështjet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.
2. Presidenti i Republikës nxjerr shkresa në ushtrimin e kompetencës së tij për:
 - a) të dhënë pëlqimin për hyrjen në fuqi të ligjit sipas nenit 84, paragrafi 4 i Kushtetutës;
 - b) thirrjen e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm sipas nenit 74, paragrafi 2 i Kushtetutës;
 - c) zhvillimin e seancës plenare të Kuvendit me dyer të mbyllura sipas nenit 79, paragrafi 2 të Kushtetutës;
 - ç) propozimin e kandidaturave në Kuvend;
 - d) të kërkuar mendim dhe të dhëna me shkrim nga Kryeministri, ministrat dhe drejtuesit e institucioneve shtetërore për çështje që kanë të bëjnë me detyrat e tyre.
3. Dhënia e pëlqimit sipas shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni jepet jo më vonë se 24 orë nga paraqitja e kërkesës nga ana e Kuvendit. Kërkesa e Kuvendit shoqërohet me kopje të projektligjit, për të cilin kërkohet dhënia e pëlqimit dhe me një relacion shpjegues për nevojën e hyrjes në fuqi menjëherë të tij. Në rast se Presidenti i Republikës nuk jep pëlqimin me shkrim brenda afatit të përcaktuar në këtë

pikë, konsiderohet se kërkesa nuk është marrë në konsideratë. Në çdo rast Kuvendi vihet në dijeni për dhënien ose jo të pëlqimit nga ana e Presidentit të Republikës në seancën plenare ku shqyrtohet projektligji.

4. Kërkesa për thirrjen e Kuvendit në sesion të jashtëzakonshëm duhet të motivojë nevojën dhe të propozojë rendin e ditës për mbledhjen e kërkuar.
5. Kërkesa për zhvillimin e seancës plenare me dyer të mbyllura duhet të përmbajë të shtjelluar shkakun dhe referencën ligjore, ku mbështetet kërkesa. Kërkesa i adresohet Kryetarit të Kuvendit dhe votohet në seancë plenare. Në rast se rrethanat e çështjes janë të tilla dhe kjo kërkohet nga Presidenti i Republikës, prezantimi i kërkesës dhe votimi i saj bëhen me dyer të mbyllura. Rezultati i votimit njoftohet publikisht.
6. Propozimi i kandidaturave Kuvendit shoqërohet me relacion përshkrues rreth procedurave të ndjekura për përzgjedhjen e kandidaturës, të dhëna statistikore për procesin dhe informacionin e dokumentacionin personal të kandidatit të propozuar.
7. Kërkesa për dhënie mendimi dhe të dhënash me shkrim parashtron qartë tematikën dhe qëllimin për të cilin kërkohet bashkëpunimi i institucionit. Institucioni është i detyruar që të përgjigjet në mënyrë të plotë dhe të hollësishme për kërkesën brenda 21 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast se tematika është e gjerë dhe kërkon punë përgatitore përtej mundësive institucionale, atëherë institucioni është i detyruar të vejë në dijeni Presidentin e Republikës për vështirësitë dhe pengesat në plotësimin e kërkesës. Presidenti mund të reduktojë rrethin e kërkesave ose të japë një afat më realist për plotësimin e tyre. Në rast të mosrepektimit të afatit për dhënien e mendimeve ose të dhënave, Presidenti i Republikës bën publik këtë fakt dhe, aty ku është e parashikuar nga ligji, kërkon marrjen e masave disiplinore nga autoriteti përkatës për drejtuesit e insitucioneve.
8. Cdo shkresë tjetër për çështje të tjera të papërfshira në pikën 2 të këtij neni, hartohet dhe është përgjegjësi e Sekretarit të Përgjithshëm të Presidencës.

Neni 44
Autorizimi

Autorizimi është akti që nxjerr Presidenti i Republikës në ushtrim të kompetencave të tij në fushën e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare sipas nenit 37 të këtij ligji dhe ligjit “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

GRAMOZ RUÇI